

# MARRËVESHJE E FINANCIMIT

## KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, më poshtë i referuar si “**Komisioni**”, i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian,  
më poshtë i referuar si “**Unioni**”,

nga njëra anë dhe

Qeveria e Shqipërisë, më poshtë i referuar si “**përfituesi IPA II**”, ose “Shqipëria”, e përfaqësuar nga Ministria e Integrimit Evropian

nga ana tjetër, dhe

Republika Helenike, më poshtë e referuar si “Greqia”, e përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizmit.

si palë e tretë,

bien dakord si më poshtë:

### **Neni 1 – Programi**

(1) Unioni bie dakord të financojë dhe përfituesi IPA II bie dakord të pranojë financimin e Programit transnacional të bashkëpunimit, siç përcaktohet në Shtojcën I të miratuar nga Vendimi për Zbatim i Komisionit me Nr. CRIS 2015/6619 të datës 25 shtator 2015:

Programin “Interreg V-B Ballkan- Mesdhe”  
CCI: 2014TC16M4TN003  
më poshtë i referuar si “Programi”.

(1) Ky Program financohet nga Buxheti i Unionit mbi bazën e aktit themelor:

Rregullorja e BE me Nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe Rregullorja e Këshillit, e datës 17 Dhjetor 2013 që përcaktojnë dispozitat e përgjithshme për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian Bujqësor për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Fondi Evropian Bregdetar dhe Peshkimit, që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) me Nr. 1083/2006<sup>1</sup> (Rregullorja e Dispozitave të Përgjithshme, “CPR”) dhe të akteve të miratuara lidhur me këtë;

Rregullorja e BE me Nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe Rregullorja e Këshillit, e datës 17 Dhjetor 2013 mbi dispozitat e përgjithshme për mbështetje nga Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal drejt qëllimit evropian për bashkëpunim territorial<sup>2</sup> (Rregullorja ETC) dhe të akteve të miratuara lidhur me këtë;

---

<sup>1</sup> GZ L 347, 20.12.2013, fq. 320

<sup>2</sup> GZ L 347, 20.12.2013, fq. 259

Neni 9 (3) e Rregullores së BE me Nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe Rregullorja e Këshillit, e datës 11 mars 2014 që përcakton Instrumentin për Asistencën Para-anëtarësimin (IPA II)<sup>3</sup> ('Rregullorja IPA II', 'IPA II');

- (2) Kostoja totale e vlerësuar e këtij Programi është 39,727,654 Euro dhe kontributi maksimal i Unionit në kuadër të IPA II për këtë Program është përcaktuar në vlerën 5,126,138 Euro si kontribut nga titulli 4.

Kontributi Unionit do të ndahet në angazhime vjetore në përputhje me Shtojcën I të kësaj Marrëveshje Financimi. Asnjë pikë në këtë Marrëveshje nuk mund të interpretohet se nënkupton një angazhim financiar të Unionit në lidhje me kreditë, të cilat nuk janë miratuar akoma përmes miratimit të buxhetit të BE. Komisioni do të informojë në formë të shkruar Autoritetin Menaxhues rreth miratimit të secilit angazhim financiar të parashtruar në Shtojcën II.

Ky Program kërkon kontribute financiare si nga përfituesi IPA II ashtu edhe nga Unioni. Ndarja e kontributeve përkatëse financiare përcaktohet në Shtojcën III.

## **Neni 2 – Periudha e ekzekutimit dhe periudha e verifikimit të ligjshmërisë**

- (1) Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi do të fillojë që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe do të përfundojë 12 vite pas kësaj date.
- (2) Në Shqipëri, shpenzimet do të jenë të pranueshme për kontributin e asistencës së ERDF nëse tërhiqet nga një përfitues dhe paguhet mes 1 janar 2014 dhe 31 dhjetor 2023.

## **Neni 3 – Interpretimi**

- (1) Dispozitat në këtë Marrëveshje dhe Shtojcat e saj do të interpretohen si mbështetëse dhe plotësuese të dispozitave të kuadrit rregullator të parashikuara në Nenin 1.
- (2) Nëse ekzistojnë kundërshtime mes dispozitave në Kushtet e Veçanta të kësaj Marrëveshje dhe Shtojcave të saj e dispozitave në Shtojcën IV në veçanti ("Kushtet e Përgjithshme"), prevalojnë dispozitat në Kushtet e Veçanta të kësaj Marrëveshje.

Nëse ekzistojnë kundërshtime mes dispozitave të kësaj Marrëveshje dhe dispozitave në aktet bazë të Nenit 1(2) apo akteve të miratuara lidhur me këtë, prevalojnë dispozitat e këtij kuadri rregullator dhe kjo Marrëveshje do të ndryshohet ose korrigjohet në përputhje me Nenin 73 të Kushteve të Përgjithshme.

- (3) Objekt i dispozitave eksplicite në kundërshtim në këtë Marrëveshje, termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim me atë të atribuar në aktet themeltare të listuara në Nenin 1(2).
- (4) Objekt i dispozitave eksplicite në këtë Marrëveshje, referencat në këtë Marrëveshje janë referenca për Marrëveshje të tillë të amenduar, të plotësuar apo të zëvendësuar në çdo kohë.

---

<sup>3</sup> OJ L 77, 15.03.2014, p. 11.

- (5) Referencat në këtë Marrëveshje dhe Shtojcat për instrumentet e Bashkimit Evropian i referohen instrumenteve të ndryshuara, mbështetëse apo të zëvendësuara herë pas here.
- (6) Titujt në këtë Marrëveshje dhe Shtojcat e saj nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretim.

#### **Neni 4 – Shfuqizimi i pjesshëm dhe boshllëqet e paqëllimshme**

Në rast se një dispozitë e kësaj Marrëveshje është e shfuqizuar ose shfuqizohet, ose në rast se kjo Marrëveshje përmban boshllëqe të paqëllimshme “*lacuna*”, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshje.

Në përputhje me Nenin 73 të Kushteve të Përgjithshme, palët do të zëvendësojnë ose do të plotësojnë boshllëqet e paqëllimshme me një dispozitë tjetër të vlefshme që i afrohet qëllimit, dhe synimit të dispozitës së pavlefshme.

#### **Neni 5 – Adresat dhe Komunikimi**

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Financimit do të bëhen me shkrim, dhe do t'i referohen shprehimisht këtij Programi siç përcaktohet në Nenin 1(1) dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

##### **(a) për Komisionin**

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Rajonale dhe Urbane

B- 1049 Bruksel– Belgjikë

E-mail: [REGIO-TRANSNATIONAL-AND-INTERREGIONAL-COOPERATION@ec.europa.eu](mailto:REGIO-TRANSNATIONAL-AND-INTERREGIONAL-COOPERATION@ec.europa.eu);

##### **(b) për Republikën e Shqipërisë**

Daniela Çekani, Sekretar i Përgjithshëm

Ministria e Integrimit Evropian

Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial

Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Sheshi ”Nënë Tereza” 1010, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (0) 4 228645

E-mail: [daniela.cekani@integrimi.gov.al](mailto:daniela.cekani@integrimi.gov.al); [ana.xhilaga@integrimi.gov.al](mailto:ana.xhilaga@integrimi.gov.al)

##### **(c) për Republikën Helenike**

Autoriteti Menaxhues i Programeve Evropiane Territoriale

Leof. Georgikis Scholis 65, GR-57001, Selanik, Greqi

Qendra telefonike: +30 2310 469600 | Fax: +30 2310 469602

E-mail: [interreg@mou.gr](mailto:interreg@mou.gr) | Ëëbsite: [www.interreg.gr](http://www.interreg.gr)



## **Neni 6 – Marrëveshja Kuadër në kuadër të IPA II**

Në përputhje me Nenin 8, pika 6, të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e Asistencës Financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë nën Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II), e cila hyri në fuqi më 27 Shkurt 2015 (referuar më tej si “Marrëveshja Kuadër”), rregullat për zbatimin e Programit përcaktohen në këtë Marrëveshje të Financimit. Si pasojë, Programi duhet të zbatohet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje të Financimit ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje e Financimit plotësohet me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër, në veçanti në ato raste kur kjo Marrëveshje e Financimit nuk përmban dispozita të posaçme mbi një çështje të caktuar.

Në rast mospërputhje, nga njëra anë, ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje të Financimit dhe nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër, marrin përparësi këto të fundit.

## **Neni 7 – Shtojcat**

Kjo Marrëveshje e Financimit përbëhet nga:

- (a) këto Kushte të Veçanta;
- (b) Shtojcat e mëposhtme të cilat formojnë një pjesë integrale të saj:
  - i. Shtojca I: Programi i Bashkëpunimit “Interreg IPA-BNK”;
  - ii. Shtojca II: Plani financiar (angazhimet/detyrimet vjetore financiare);
  - iii. Shtojca III: Plani financiar (pjesë e kontributeve financiare të Unionit dhe përfituesve të IPA II sipas aksit prioritar);
  - iv. Shtojca IV: Kushtet e Përgjithshme.

## **Neni 8 - Dispozitat që përcaktojnë kushtet e aplikueshme për zbatimin e programit në përputhje me nenin 26 të Rregullores Evropiane të Bashkëpunimit Territorial (ETC)**

Në mënyrë të përgjithshme, rregullat e zbatueshme për partnerët ERDF zbatohen edhe për partnerët e IPA-s në lidhje me kushtet zbatuese për menaxhimin financiar, programimin, monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin. Megjithatë, çështja më poshtë duhet të merret në konsideratë:

- Partnerët IPA mund të jenë Partnerë Kryesorë me kusht që kushtet e nenit 13, pika 4, të Rregullores (BE) Nr. 1299/2013) ku thuhet se "Shtetet Anëtare dhe vendet e treta apo territoret që marrin pjesë në një program bashkëpunimi mund të bien dakord me përfituesin kryesor të vendosur në një vend të tretë apo territor që merr pjesë në këtë program bashkëpunimi, me kusht që autoriteti menaxhues është i kënaqur që përfituesi kryesor mund të kryejë detyrat e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 dhe se kërkesat për menaxhimin, verifikimin dhe auditin janë plotësuar " përmbushur.

Dispozitat që i dërgohen Shtojcës IV:

- (a) Duke pasur parasysh se alokimi i Asistencës Teknike është bërë ndaras për kreun 1b dhe kreun 4, kontributi për Asistencën ERDF nga IPA II është mbajtur në 358 830,00 Euro.

## **Neni 9 – Dispozitat Plotësuese të Shtojcës IV**

Dispozitat plotësuese të Shtojcës IV:

- (a) në plotësim të nenit 12, pika 2, të Shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse në Program kanë rënë dakord të aplikojnë opsionet e shkronjës (d);
- (b) në plotësim të nenit 33, pika 1, të Shtojcës IV, përfituesi IPA II ka zgjedhur për të përdorur Udhëzuesin Praktik për Procedurat Kontraktuese për Veprimet e Jashtme të BE-së;
- (c) në plotësim të nenit 34, pika 1, të Shtojcës IV, këto Kushte të Veçanta nuk lejojnë pjesëmarrjen në thirrjen për propozime të subjekteve pa personalitet juridik;
- (d) në plotësim të nenit 34, pika 5, të Shtojcës IV, pranueshmëria sipas këtij neni nuk është e kufizuar më tej në lidhje me kombësinë, vendndodhjen gjeografike ose natyrën e aplikantëve;
- (e) në plotësim të nenit 40, pika 1, të Shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse në Program dhe përfituesi IPA II nuk e kanë autorizuar autoritetin e auditimit për të kryer direkt funksionet e tij në të gjithë territorin. Ata nuk kanë specifikuar se kur autoriteti i auditimit duhet të shoqërohet nga një auditues i një Shteti Anëtar ose një përfituesi IPA II;
- (f) në plotësim të nenit 41, pika 2, të Shtojcës IV, përfituesi IPA II nuk e ka autorizuar autoritetin e auditimit për të kryer direkt funksionet e parashikuara në nenin 127 të Rregullores (BE) Nr. 1303/2013 në të gjithë territorin e mbuluar nga programi i bashkëpunimit;
- (g) në plotësim të nenit 44, të Shtojcës IV, Përfituesi IPA II Koordinatori Kombëtar e ka deleguar rolin e tij menaxhues për koordinimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin përkatës transkombëtar në Ministrinë e Integrimit Europian;
- (h) në plotësim të nenit 48, të Shtojcës IV, shkalla e bashkëfinancimit dhe shuma maksimale e asistencës ERDF për aks prioritar, për kontribut nga buxheti Kreu 1b dhe për kontribut nga buxheti Kreu 4 (IPA II) përcaktohen siç është përcaktuar në Shtojcën III;
- (i) në plotësim të nenit 56, pika 3, të Shtojcës IV, metoda e zgjedhur për këtë Program është ajo e përmendur në shkronjën (a) të nënparagrafit të parë të këtij neni;
- (j) në plotësim të nenit 67, pika 3, të Shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse kanë vendosur të rimarrin shumën e paguar padrejtësisht në rast se shuma që do të mbulohet nga përfituesi, pa përfshirë interesin, nuk e kalon vlerën prej 250 Euro nga kontributi i ERDF-së .

## **Neni 10 - Marrëveshja shtesë dypalëshe**

Greqia dhe Shqipëria kanë rënë dakord që rregullimet e detajuara mes tyre nuk duhet të jenë pjesë e kësaj Marrëveshje të Financimit në formën e një Shtojce të veçantë, për shkak se të gjitha çështjet janë të mbuluara sa duhet në Program, në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta, dhe në Manualin e Programit, Manualin e Zbatimit të Projektit dhe Manualin e Asistencës Teknike në versionet e saj të 26.11.2015 dhe ndryshimet e mëvonshme.

Këto rregullime të detajuara kanë përcaktuar në mënyrë shteruese të gjitha rregullat që qeverisin marrëdhëniet respektive midis autoritetit menaxhues (përfshi sekretariatit teknik), autoritetit certifikues dhe autoritetit të auditimit të Programit dhe autoriteteve përkatëse në Shqipëri.

### **Neni 11 - Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje e Financimit hyn në fuqi në datën në të cilën Komisioni merr një njoftim nga përfituesi IPA II që konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit IPA II të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi. Komisioni informon përfituesin IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi.

Kjo Marrëveshje e Financimit është hartuar në tri kopje në gjuhën angleze, një kopje i dorëzohet Komisionit, një kopje për Shqipërinë dhe një kopje për Greqinë.

Për Republikën e Shqipërisë:

**Znj. Klajda GJOSHA**  
Ministër i Integritimit Evropian

Koordinator Kombëtar IPA

Nënshkrimi:

Tiranë, .../.../...

Për Komisionin:

**Z. Marc Lemètré**  
Drejtor i Përgjithshëm DG REGIO

Nënshkrimi:

Bruksel, ... / ... / ...

Për Republikën e Greqisë:

**Z. Giorgos Stathakis**  
Ministër i Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizmit

Nënshkrimi:

Selanik, ...../... / ...